



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

MBI RISHPALLJEN E PLATFORMAVE TË PARTNERITETIT

FTESË PËR PJESËMARRJE

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në cilësinë e institucioneve bashkë kryesuese për *Kapitullin 10 “Shoqëria e informacionit dhe media”* po organizojnë tryezën e Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian dedikuar këtij kapitulli.

Kapitulli 10 përbën një kapitull të rëndësishëm të *acquis* së Bashkimit Evropian dhe është një ndër kapitujt për hapjen e *Cluster*-it të 3-të të negociatave të anëtarësimit. Një nga detyrimet kryesore të Shqipërisë në këtë fazë të integritit është edhe përafrimi i legjislacionit. Në këtë kuadër, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë së bashku me institucionet e saj kontribuese, harton dhe miraton masat ligjore për përafrim me legjislacionin e BE-së nëpërmjet Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE).

Në përmbushje të detyrimeve tona të përbashkëta sa i takon integritit të Shqipërisë në BE, kjo *Tryezë* Partneriteti do t'i japë mundësinë të gjitha palëve që të sigurojnë një proces transparent, gjithëpërfshirës dhe profesional. Prania dhe njohuritë tuaja janë një faktor i pazëvendësueshëm në mbështetje të këtij procesi që Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e vlerëson në mënyrë të veçantë. Për të qenë pjesë e kësaj tryeze ftohen përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, të pushtetit vendor, të komunitetit të biznesit, të shoqatave të punëmarrësve, të botës akademike, mediave të cilët kanë interes për të ndarë ekspertizën e tyre në fushën e komunikimeve elektronike *acquis*-ve të Bashkimit Evropian, të cilat synojnë të eliminojnë pengesat për funksionimin efektiv të tregut të brendshëm në shërbimet dhe rrjetet e telekomunikacionit, të promovojë konkurrencën dhe të mbrojnë interesat e konsumatorëve në këtë sektor, duke përfshirë disponueshmërinë e shërbimeve universale moderne. Për sa i përket politikës audio-vizuale, *acquis* kërkojnë përafrimin ligjor me Direktivën e Televizionit pa Kufij, e cila krijon kushtet për lëvizjen e lirë të

transmetimeve televizive brenda BE-së. Gjithashtu, *acquis* synon krijimin e një kuadri rregullator transparent, të parashikueshëm dhe efektiv për transmetimet publike dhe private në përputhje me standardet evropiane dhe kërkon kapacitet për të marrë pjesë në programet komunitare Media Plus dhe Media Training.

Aplikimi kryhet duke depozituar nje letër interesi ku të jenë specifikuar eksperiencat e mëparshme në fushat e mësipërme si dhe ekspertiza që mund të jepet lidhur me fushat që mbulon *Kapitulli 10 "Shoqëria e informacionit dhe media"* dhe CV të personit apo grupimit që përfaqëson, brenda datës **30.09.2022** në adresën elektronike :

- Erida.sinanaj@infrastruktura.gov.al.

- Leandro.xhama@infrastruktura.gov.al

- Jona.haderi@akshi.gov.al